

The top half of the cover features a vibrant, abstract background of overlapping brushstrokes in the colors of the rainbow: red, orange, yellow, green, blue, and purple. The strokes are thick and textured, creating a sense of movement and energy.

Aleanca LGBTI

Maj 2025

# Situata e Komunitetit LGBTI+ në Shqipëri

Një Analizë e të Dhënave të Pyetësorit Vjetor 2024-2025  
në Vështrim Krahasues me Periudhën 2020-2024

Autore: LL.M Dea Nini



**erim**  
= Equal Rights  
Independent  
Media



**GLOBAL FUND FOR  
WOMEN**

**EQUALITY  
FUND**

Ky raport është përgatitur nga autorët në mënyrë të pavarur.  
Përmbajtja dhe opinionet e shprehura nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht pikëpamjet  
zyrtare të donatorëve apo ndonjë institucioni tjetër të përfshirë.

## **Përmbajtja**


- 1 Hyrje
- 2 Akses i Personave LGBTI+ në Shëndetësi:
- 3 Njohja Ligjore e Personave LGBTI+ dhe Qasja në Institucione
- 4 Edukimi dhe Qasja në Sistemin Arsimor
- 5 Punësimi
- 6 Strehimi
- 7 Situata e Diskriminimit dhe Dhunës me Bazë Statusin LGBTI+
- 8 Nevojat Kryesore të Individëve LGBTI+ për Shërbime
- 9 Largimi nga Vendi dhe Synimi për të Migruar
- 10 Përmbledhje Krahasimore: Të Dhënat e Pyetësorit Vjetor 2024-2025  
Përballë Gjetjeve të Periudhës 2020-2024
- 11 Përfundime dhe Rekomandime

## Hyrje

Në vitin 2024, Aleanca LGBTI realizoi një pyetësor kombëtar me 195 persona që identifikohen si LGBTI+ në 12 qytete të Shqipërisë, me synimin për të vlerësuar situatën e tyre të përgjithshme, nevojat më urgjente dhe qasjen e tyre në të drejtat e garantuara me ligj dhe në shërbime. Të anketuarit u përkasin moshave nga 14 deri mbi 50 vjeç, me një moshë mesatare rreth 29 vjeç, dhe me një shumicë nën 30 vjeç. Pyetësi përfshiu një gamë të gjerë të anketuarish sa u përket orientimeve seksuale, identiteteve gjinore dhe karakteristikave të tjera, ku: 37.5% u identifikuan si burra gej, 19% si gra lezbike, 26.5% si biseksualë, 8% si persona transgjjinorë dhe 4% si individë jo-binare. Një përqindje e vogël, rreth 0.5% e të anketuarve, u identifikuan si persona interseks, dhe 4.5% u identifikuan me identitete të tjera të ndryshme nga ato të përfshira në pyetësor.

Identifikohem:


195 responses



Ndërkohë që kampioni ishte gjithëpërfshirës në aspektin e përkatësisë gjeografike, një pjesë e konsiderueshme (60%) e të anketuarve jetonin në rajonin e Tiranës, duke reflektuar përqendrimin urban të komunitetit LGBTI+ në Shqipëri.

Jam banor/e në:

195 responses



Nga rezultatet e pyetësorit, rezulton se vetëm 25% e të anketuarve kishin përfituar nga shërbimet dhe/ose kishin frekuentuar qendrën komunitare të Aleancës LGBTI apo organizatave të tjera që kanë në qendër punën me komunitetet LGBTI+ në Shqipëri, çka sugjeron se një përqindje e madhe e komunitetit mbetet e shkëputur nga rrjetet formale të mbështetjes dhe strukturat e organizuara të advokimit.

## Objektivat dhe Metodologjia

### Ky raport synon të:

Dokumentojë realitetet dhe sfidat aktuale që përjetojnë personat LGBTI+ në Shqipëri, duke u bazuar në të dhëna të drejtpërdrejta për vitin 2024-2025;

Analizojë pabarazitë strukturore dhe sociale me të cilat përballen individët LGBTI+ në fusha kyçe të jetës së përditshme, si shëndetësia, njohja ligjore, arsimi, punësimi, strehimi, siguria dhe qasja ndaj shërbimeve;

Krahasojë të dhënat e vitit 2024-2025 me ato të viteve të mëparshme (2020-2024), për të identifikuar trendin, nivelet e progresit, mosndryshimit ose regresit progresiv në qasjen në të drejta, njohje ligjore dhe shërbime gjithëpërfshirëse për personat LGBTI+.

Pyetësi përmbante si pyetje të mbyllura ashtu edhe të hapura, duke mundësuar një kombinim të metodave sasiore të mbledhjes së të dhënave me

interpretimin cilësor të tyre. Të dhënat u mblodhën mes një pyetësi të publikuar online, por edhe përmes kontakteve të drejtpërdrejta në hapësira komunitare, duke siguruar përfshirjen e zërave që shpesh mbeten jashtë proceseve formale të konsultimit.

## **Struktura dhe Qasja e Analizës**


Raporti paraqet një ndarje tematike të gjetjeve në tetë fusha kryesore: shëndetësi, njohje ligjore, arsim, punësim, strehim, diskriminim dhe dhunë, nevoja për shërbime, dhe synimet për migrim. Çdo seksion përmban një përmbledhje statistikore, të mbështetur me interpretimin narrativ dhe të bazuar në kuadrin aktual ligjor kombëtar si dhe në detyrimet pozitive të shtetit shqiptar në nivel ndërkombëtar ndaj çështjeve LGBTI+. Gjithashtu, çdo seksion përfshin një analizë krahasuese ndërmjet gjetjeve të vitit 2024-2025 dhe atyre të periudhës 2020-2024, për të vlerësuar nëse situata e personave LGBTI+ gjatë vitit të fundit është përmirësuar, përkeqësuar apo mbetur e pandryshuar në raport me 4-vjeçarin e kaluar.

## **Aksesi i Personave LGBTI+ në Shëndetësi:**

Të anketuarit LGBTI+ për vitin 2024-2025 raportuan sfida të konsiderueshme në qasjen ndaj kujdesit shëndetësor gjithëpërfshirës. Pothuajse dy të tretat (68%) e të anketuarve raportuan se kishin marrë të paktën njëherë shërbime mjekësore gjatë vitit të fundit. Nga përgjigjet e dhëna, rezulton se rreth 14% e të gjithë të anketuarve që morën shërbim mjekësor gjatë vitit të fundit përjetuan diskriminim nga personeli shëndetësor për shkak të statusit të tyre LGBTI+, një shifër shqetësuese, duke pasur parasysh se kujdesi shëndetësor duhet të jetë një mjedis i sigurt për të gjithë.

A keni hasur diskriminim nga ana e personelit shëndetësor?

195 responses




Ky rezultat thekson qasjen e kufizuar që kanë individët LGBTI+ ndaj shërbimeve të kujdesit parësor mjekësor dhe shëndetit seksual në Shqipëri, çka është theksuar edhe nga shumë raporte advokimi gjatë periudhës 2020-2024. Shumica e personave që raportuan diskriminim në aksesin në shëndetësi (59%), u shprehën se diskriminimi/trajtimi i pafavorshëm erdhi direkt nga mjekët e familjes dhe stafi spitalor ndërsa pjesa tjetër (41%) raportuan se sjellja diskriminuese erdhi nga infermierët dhe/ose pacientët e tjerë. Këto shifra tregojnë se paragjykimi dhe sjelljet diskriminuese ndaj personave LGBTI+, mbeten ende prezente në disa nivele të sistemit shëndetësor.

Një gjetje veçanërisht shqetësuese është shmangia e kujdesit të nevojshëm mjekësor për shkak të frikës nga stigmatizimi dhe diskriminimi. Ndërkohë që 29% e të anketuarve u shprehën se kanë kryer vizita të shëndetit seksual apo riprodhues gjatë vitit të fundit, gati një e katërta e tyre (25%) i shmangu ato edhe pse ndiente se i kishte të nevojshme. Alternativa “I kam shmangur vizitat e shëndetit seskual dhe riprodhues, edhe pse mendoj se më nevojiteshin,” u zgjodh nga rreth 1 në 4 të anketuar.

A keni realizuar vizita të shëndetit seksual/riprodhues gjatë vitit të fundit?

195 responses




Kjo shifër tregon se një grup personash LGBTI+ janë potencialisht në rrezik për shëndetin e tyre sepse nuk ndihen të sigurt për të kërkuar shërbime për shëndetin seksual, gjinekologjik apo urologjik. Kjo shmangie e kontrolleve mjekësore mund të sjellë probleme shëndetësore të patrajtuara dhe është një tregues i qartë sesi stigma krijon barriera reale në qasjen në kujdesin mjekësor për individët LGBTI+.

Për personat transgjjinorë dhe jo-binarë, qasja në kujdes të specializuar mjekësor mbetet tepër e kufizuar. Nga 24 të anketuar që u identifikuan si transgjjinorë ose jo-binarë, vetëm 2 raportuan se kishin mundur të këshilloheshin me një mjek vendas mbi terapitë hormonale apo ndërhyrjet mjekësore që lidhen me afirmimin e gjinisë gjatë vitit të fundit. Pjesa tjetër (mbi 90%) nuk pati asnjë mundësi për të kryer konsulta të tilla, çka pasqyron se sistemi shëndetësor shqiptar vijon të mos i adresojë nevojat shëndetësore të personave transgjjinorë.

Nëse identifikoheni si person transgjini or ose me gjini jo binare, a keni patur mundësi të konsultoheni me një mjek vendas lidhur me trajtime specifike horm...dryshimit të seksit biologjik gjatë vitit të fundit?

63 responses



Edhe pse Shqipëria së fundmi ka punuar mbi një protokoll mjekësor për trajtimin hormonal të personave transgjini, ky protokoll mbetet i pa miratuar, e për pasojë zbatimi i tij ende nuk ka nisur. I vetmi person interseks i anketuar raportoi se i ishte nënshtruar ndërhyrjeve mjekësore të panevojshme dhe jokonsensuale në fëmijëri, çka ngre sërish shqetësimin mbi praktikën e dëmshme mjekësore të kryera ndaj fëmijëve interseks.

Gjithashtu, qasja ndaj kujdesit shëndetësor për gratë lesbike dhe biseksuale mbetet problematike dhe e kufizuar. Mes grave që u identifikuan si lesbike ose biseksuale, vetëm 19% e tyre raportuan se kishin kryer vizita gjinekologjike ose të shëndetit riprodhues gjatë vitit të fundit, ndërsa mbi 28% raportuan se i kishin shmangur këto kontrolle qëllimisht edhe pse ndjenin se i kishin të nevojshme.

Nëse identifikoheni si vajzë/grua lesbike ose biseksuale, a i jeni nënshtruar vizitave specifike mjekësore dhe atyre të shëndetit seksual/riprodhues me mjekë vendas gjatë vitit të fundit?

98 responses




Këto të dhëna tregojnë se stigma mbizotëruese dhe mungesa e besimit të mjekëve vijon t'i shtyjë gratë e komunitetit LGBTI+ të shmangin kontrollat e rëndësishme shëndetësore.

Vlen të theksohet se vetëm një e katërta e grave lesbike/biseksuale që dëshirojnë të kenë fëmijë do të konsideronin të përdornin shërbime fertiliteti (IVF) brenda Shqipërisë. Kur u pyetën për planet e tyre të ardhshme mbi planifikimin familjar, 27% u shprehën se do të donin të kryenin fertilizim in-vitro në vend, ndërsa shumica (55%) u përgjigjën se nuk do të tentonin të përfitonin nga ky shërbim në Shqipëri, ndërkohë që 17% u shprehën se preferonin adoptimin. Hezitimi për të përdorur meodat e riprodhimit mjekësor të asistuar (konkretisht, IVF) në Shqipëri pasqyron qartë mungesën e besimit në sistemin mjekësor vendas në lidhje me trajtimin e çifteve lesbike (apo grave beqare), si dhe pengesat ligjore aktuale në lidhje me të drejtat e çifteve të njëjtit seks për të krijuar familje dhe për t'u bërë prindër.

Nga ana tjetër, burrat gej dhe biseksualë shprehën interes të lartë për metodat moderne të parandalimit të HIV-it, por gjithashtu treguan mungesë informacioni mbi to. Ndër të anketuarit meshkuj gej/biseksualë, 66% u shprehën se ishin të interesuar të përdornin PrEP/PEP (profilaksi para dhe pas ekspozimit ndaj HIV) nëse do të ishte e disponueshme në vend. Një pakicë e konsiderueshme e tyre (18%) u përgjigj se nuk kishte fare informacion mbi PrEP-in dhe PEP-in, ndërsa 16% nuk shprehën interes ndaj këtyre metodave.

Nëse identifikoheni si djalë/burrë gej ose biseksual, a jeni i interesuar për të pasur akses në programet e parandalimit të HIV si PrEP dhe PeP (p...it të HIV para dhe pas ekspozimit) brenda vendit?

118 responses



Niveli i lartë i interesit tregon një kërkesë për programe efektive dhe gjithëpërfshirëse PrEP dhe PEP në Shqipëri, ndërsa mungesa e informacionit tregon nevojën për një edukim më të gjerë rreth këtyre metodave.

## Njohja Ligjore e Personave LGBTI+ dhe Qasja në Institucione


Njohja ligjore e të drejtave dhe personave LGBTI+ në Shqipëri mbetet e kufizuar, çka pasqyrohet qartë edhe në gjetjet e pyetësorit për vitin 2024-2025. Shqipëria vijon të mos njohë ligjërisht bashkimet e të njëjtit seks, qoftë bashkëjetesën, qoftë martesën, si dhe nuk mundëson njohjen ligjore të gjinisë për personat transgjinnorë. Kjo situatë mosnjohjeje ligjore, përkthehet në një ndjenjë përjashtimi dhe pasigurie juridike për qytetarët LGBTI+ në vend. “Mungesa e njohjes ligjore” u citua nga gati gjysma (48%) e të anketuarve si arsyeja qendrore dhe më madhore, për shkak të së cilës po mendonin të largoheshin nga Shqipëria (diskutuar më tej në seksionin mbi Migrimin).

Një shumicë absolute e individëve të anketuar LGBTI+ shprehet se pa njohje ligjore të marrëdhënieve dhe identitetit të tyre, ata trajtohen nga shteti si qytetarë të dorës së dytë, të zhveshur nga të drejtat që gëzon pjesa tjetër e shoqërisë (si martesë, bashkëjetesa ligjore, trashëgimia, çështje të prindërimit, birësimi, apo edhe thjesht pasja e një ID-je që reflekton gjininë e tyre aktuale). Në kuadër të qasjes në informacion sa u përket garancive ligjore, të dhënat e

pyetësorit tregojnë se vetëm 22% e të anketuarve janë të informuar se ekziston një Plan Kombëtar Veprimi për personat LGBTI+, që do të thotë se shumica e personave LGBTI+ nuk janë të vetëdijshëm për të drejtat dhe kuadrin ligjor në fuqi në lidhje me angazhimet e qeverisë shqiptare ndaj të drejtave LGBTI+.

A jeni në dijeni të ekzistencës së një Plani Kombëtar Veprimi për personat LGBTI+?

195 responses




Vetëm nga kjo e dhënë, kuptojmë se Plani Kombëtar i Veprimit (2016-2020 dhe 2021-2027), nuk është promovuar dhe zbatuar siç duhet (në fakt, shumica e masave të Planit të Veprimit nuk janë zbatuar ende).

Nëse flasim për institucionet kryesore shtetërore që janë të ngarkuara me mbrojtjen dhe garantimin e të drejtave të njeriut për personat LGBTI+, të anketuarit treguan nivel të ulët ndërgjegjësimit mbi rolin e këtyre institucioneve dhe besimi në veprimtarinë e tyre. Vetëm 36% e të pyeturve janë të vetëdijshëm për punën dhe rolin e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ndërsa pjesa tjetër nuk e njeh këtë institucion. 90% e të anketuarve u shprehën se nuk kanë raportuar kurrë incidente të diskriminimit apo dhunës tek Komisioneri, Policia e Shtetit apo Avokati i Popullit.

Gjetjet e pyetësorit tregojnë një mosbesim të thellë ndaj sistemit të rendit dhe sigurisë, ku 88% e të anketuarve u shprehën se nuk i besojnë institucioneve të rendit në Shqipëri.

A besoni në Institucionet e rendit në Shqipëri?

195 responses



Ky nivel i lartë mosbesimi shkon paralelisht me numrin e ulët të raportimeve në institucione të rasteve të dhunës dhe diskriminimit nga personat LGBTI+.

Në Raportin e Progresit për Shqipërinë drejt anëtarësimit në BE, u theksua se diskriminimi “mbetet shumë i përhapur, sidomos në aksesin në kujdes shëndetësor, arsim, drejtësi, punësim dhe strehim”, dhe se deri në vitin 2023, 51% e individëve LGBTI+ shqiptarë ndiheshin të diskriminuar në të paktën një fushë të jetës<sup>1</sup>. Ky kontekst tregon se pavarësisht ekzistencës së garancive ligjore që përlligjin mbrojtjen dhe aplikohen mbi individët LGBTI+, zbatimi i tyre në praktikë mbetet i ulët.

Shifrat e ulëta mbi raportimin e incidenteve të dhunës dhe urrejtjes për shkak të stuatimit LGBTI+ në anketën tone, përputhen me të dhënat zyrtare që tregojnë se shumë pak raste krimesh urrejtjeje apo diskriminimi që u përkasin personave LGBTI+ arrijnë të adresohen përmes Policisë së Shtetit, institucioneve të pavarura dhe sistemit të drejtësisë.

Të dhënat e pyetësorit tregojnë se vetëm 16 persona ose 11.6% e atyre që raportuan se ishin përballur me incidente serioze gjatë vitit të fundit, e raportuan rastin e tyre te një autoritet shtetëror, çka do të thotë se vetëm 1 në 11 raste dhune/diskriminimi raportohen institucionalisht.


---

<sup>1</sup> Link:

[https://enlargement.ec.europa.eu/document/download/a8eec3f9-b2ec-4cb1-8748-9058854dbc68\\_en?filename=Albania%20Report%202024.pdf](https://enlargement.ec.europa.eu/document/download/a8eec3f9-b2ec-4cb1-8748-9058854dbc68_en?filename=Albania%20Report%202024.pdf)

A e raportuat incidentin tuaj?

138 responses



Nga ata që iu drejtuan policisë apo institucioneve të tjera për të raportuar rastin e tyre, vetëm 2 persona nga 16, pra 12.5% e atyre që raportuan u shprehën se morën një zgjidhje përfundimtare për çështjen e tyre. Shumica nuk morën asnjë përgjigje dhe vijojnë të mos kenë asnjë informacion në lidhje me vijueshmërinë e çështjeve të raportuara.


## Edukimi dhe Qasja në Sistemin Arsimor

Rezultatet e anketës vijojnë të identifikojnë ambientet arsimore në Shqipëri si sfiduese dhe jo mikpritëse për të rinjtë LGBTI+. Sa i përket kampionit të të anketuarve, rreth 54% kanë përfunduar arsimin e lartë (universitetin), dhe 12% kanë ndjekur studime pasuniversitare. Megjithatë, një shumicë absolute e atyre që kishin frekuentuar së fundmi shkollën, raportuan problematika të shpeshta me paragjykimet dhe mungesën e përfshirjes për shkak të statusit të tyre LGBTI+.

Një shumicë dërrmuese prej 73% e të anketuarve e përshkruan ambientin shkollor në Shqipëri si “të pasigurt” për grupet e marginalizuara (përfshirë studentët LGBTI+).

Nga informacionet që keni, si do ta cilësonit mjedisin e shkollës në Shqipëri në raport me individët që u përkasin grupeve vulnerabël?

195 responses



Vetëm 4% e pjesëmarrësve në pyetësor i konsiderojnë shkollat si të sigurta, ndërsa pjesa tjetër i vlerësoi si mesatarisht të sigurta ose nuk kishte opinion mbi to. Këto shifra mbeten tejet shqetësuese, pasi afro tre të katërtat e të anketuarve LGBTI+ e perceptojnë shkollën shqiptare si një ambient të pasigurt për të rinjtë LGBTI+, nisur nga përvoja reale me bullizmin, ngacmimet ose përjashtimin.


Pyetjet specifike të anketës në seksionin e edukimit hedhin më shumë dritë mbi këto përvoja. Ndër të anketuarit që janë ende në shkollë ose që kanë pasur kontakt të drejtpërdrejtë me shkollat, 25% deklaruan se kishin vështirësi në ndjekjen ose qasjen në shkollën e mesme ose profesionale gjatë vitit të fundit për shkak të orientimit seksual, identitetit gjinor apo karakteristikave të seksit. Për më tepër, 46% e të anketuarve pohuan se njohin të paktën një individ tjetër LGBTI+ që ka hasur vështirësi në arsim për të njëjtat arsye. Këto të dhëna tregojnë se shumë të rinj LGBTI+ përballen me pengesa në systemin arsimor dhe në ambientet e shkollave. Vlen të përmendet se një nëngrup prej rreth 2% e të anketuarve nuk e ka përfunduar arsimin e detyruar (8/9-vjeçar), ku ndër arsyet e deklaruara përfshihen përjashtimi familjar dhe bullizmi për shkak të statusit LGBTI+.

Në lidhje me adresimin e rasteve të bullizmit, diskriminimit dhe dhunës brenda shkollave, pyetësori tregon se incidentet e bullizmit, dhunës dhe diskriminimit mbeten të patrajtuara nga autoritetet drejtuese në një shumicë absolute rastesh.

Vetëm 15% e atyre që përjetuan ngacmime ose diskriminim në shkollë gjatë vitit të fundit pohuan se e raportuan rastin pranë drejtuesve të shkollës.

A jeni ankuar ndonjëherë gjatë vitit të fundit në organet brenda shkollës nëse jeni përballur me paragjykim/diskriminim/dhunë?


113 responses



Shumica dërrmuese (85%) nuk paraqitën asnjë ankesë. Kur u pyetën pse nuk raportuan, nxënësit dhanë arsye shqetësuese, ndër të cilat frika se do të diskriminoheshin nga vetë stafi i shkollës, frika se nuk do të merreshin seriozisht dhe frika se anonimati nuk do të ruhej në rast se raportonin. Afërsisht 40% e studentëve që nuk e raportuan rastin e tyre pohuan se kishin frikë nga ndëshkimi ose tallja nga drejtuesit e shkollës. Rreth 38% e tyre u shprehën se kishin frikë se do të ekspozoheshin brenda shkollës si LGBTI+, ndërsa 13 persona u shprehën se nuk kishin raportuar për shkak të presionit që u kishin bërë drejtuesit/mësuesit brenda shkollave të tyre.

Nëse JO, arsyeja ishte (mund të përzgjidhni më tepër se një alternativë):

94 responses



Këto përgjigje pasqyrojnë një klimë shkollore ku nxënësit LGBTI+ ndihen se është më e sigurt të heshtin mbi abuzimin se sa ta raportojnë atë. Nxënësit dhe studentët LGBTI+ vijojnë të frikësohen nga fakti se raportimi i bullizmit, dhunës dhe diskriminimit mund ta përkeqësojë situatën e tyre përmes hakmarrjes, talljeve ose ekspozimit.

Një tjetër shqetësim që ngrihet në bazë të rezultateve të pyetësorit vjetor të Aleancës LGBTI për vitin 2024-2025 është përmbajtja e kurrikulave aktuale shkollore. Vetëm 7% e të anketuarve u shprehën se tekstet shkollore kishin informacion të paanshëm mbi çështjet LGBTI+. 51% e të anketuarve u shprehën me siguri të plotë se tekstet aktuale me të cilat studionin nuk përmbanin asnjë informacion të plotë dhe të paanshëm në lidhje me temat LGBTI+ dhe edukimin gjithëpërfshirës seksual, ndërsa pjesa tjetër nuk kishte informacion për këtë çështje. Këto të dhëna, konfirmojnë faktin se kurrikulat aktuale arsimore në Shqipëri mbeten të heshtura ndaj çështjeve LGBTI+ ose i portretizojnë negativisht ato, një gjetje kjo e theksuar në disa dokumente advokuese të Aleancës LGBTI+<sup>2</sup>.

Sa i përket personelit arsimor, vetëm 12% e të anketuarve besojnë se mësuesit dhe drejtuesit e shkollave janë të informuar mbi çështjet LGBTI+, ndërsa 71%


<sup>2</sup> Link:

<https://aleancalgbt.org/publication/albania-under-upr-aleanca-lgbti-and-ilga-worlds-joint-submission/>

shprehen se stafit arsimor dhe drejtues i mungon tërësisht informacioni dhe se në disa raste, është drejtpërdrejt stafi shkollor që shpëreh hapur qëndrime diskriminuese ndaj çështjeve LGBTI+.

A mendoni se janë të informuar mësuesit dhe drejtuesit e institucioneve të edukimit lidhur me çështjen LGBTI+?

172 responses



Kombinimi i një kurrikule jo përfshirëse ndaj temave LGBTI+ me mungesën e informacionit të personelit shkollor mbi këto çështje, bashkuar me numrin e ulët të rasteve të raportimit të bullizmit, dhunës dhe diskriminimit për shkak të statusit LGBTI+, dëshmon se studentët LGBTI+ vijojnë të ndjehen të përjashtuar, të pakuptuar dhe jo të sigurt në sferën e edukimit.

## Punësimi

Punësimi është një tjetër fushë kritike në të cilën personat LGBTI+ në Shqipëri vijojnë të përballen me problematika të thella, duke përfshirë problematika të spektrit më të përgjithshëm si mungesa e ofertës për punë dhe sfidat ekonomike, por edhe problematika specifike që lidhen me përjashtimin dhe diskriminimin mbi baza të orientimit seksual dhe identitetit gjinor, duke përfshirë këtu edhe shprehjen gjinore.

Sipas rezultateve të pyetësorit vjetor, rreth 70% e të anketuarve kishin qenë të punësuar formalisht dhe informalisht gjatë vitit të fundit, ndërsa rreth 30% e tyre ishin të papunë në momentin e realizimit të pyetësorit. Nga personat që

raportuan se ishin të punësuar, 47% e tyre u shprehën se kishin një kontratë të rregullt pune, shumica prej 44% ishin të punësuar informale, ndërsa 9% ishin të vetëpunësuar. Këto shifra tregojnë se një pjesë e konsiderueshme e personave LGBTI+ vijojnë të punojnë në kushte të pasigurta, çka mund të rrisë në vijim rrezikun e diskriminimit, pasi punonjësit informale gëzojnë më pak mbrojtje juridike në rast abuzimesh dhe shkeljesh ligjore.

Sa i përket të ardhurave, ndër ata që raportuan fitime mujore, rreth gjysma (48%) përfitonin mesatarisht mbi 70,000 lekë në muaj, rreth 36% kishin të ardhura mesatare që varionin nga 40,000-70,000 lekë, kurse 16% fitonin më pak se 40,000 lekë në muaj, pra më pak se paga minimale e miratuar aktualisht në Shqipëri.

Një nga gjetjet kryesore të seksionit të punësimit në pyetësor mbetet ajo e lidhur me ndjenjën e sigurisë dhe respektit në vendin e punës. Ndër të anketuarit që kanë punuar gjatë vitit 2024-2025, formalisht apo informalisht, vetëm 23% e tyre deklaruan se ishin ndjerë të sigurt dhe të respektuar në vendin e tyre të punës. 47% e të anketuarve pohuan se ndjeheshin disi të sigurt apo të respektuar në ambientin e punës, ndërsa 30% nuk ishin ndjerë aspak të sigurt apo të respektuar në vendin e tyre të punës gjatë vitit të fundit. Nga këto të dhëna rezulton se gjatë vitit të fundit, 1 në 3 të punësuar LGBTI+ e cilësuan vendin e punës si një ambient të pasigurt për ta. Ndër shkaqet e renditura për këtë vlerësim, të anketuarit listuan dëgjimin e batutave homofobe/transfobe në vendin e punës, trajtimin e diferencuar nga punëdhënësi apo kolegët pasi dyshonin për statusin e tyre LGBTI+ si dhe ngacmimet e drejtpërdrejta.


Në bazë të praktikave më të mira, një faktor kryesor që përmirëson ndjesinë e sigurisë në punë për personat LGBTI+ është dalja hapur në vendin e punës. Anketa tregoi se rreth 70% e të anketuarve të punësuar aktualisht apo në të shkuarën nuk kishin dalë kurrë hapur dhe e kishin fshehur aktivisht orientimin e tyre seksual apo identitetin gjinor në vendin e punës. Vetëm 8 nga 195 të anketuar pohuan se kishin dalë hapur në vendin e tyre të punës si persona LGBTI+, pasi punonin në sektorin e të drejtave të njeriut, një sektor që mbetet përgjithësisht më pranues ndaj punëmarrësve LGBTI+. të jetë më pranues. Këto shifra tregojnë se shumica e të punësuarve LGBTI+ vijojnë të fshehin një pjesë thelbësore të identitetit të tyre në vendin e punës për të shmangur pasojat negative. Të anketuarit që raportuan se nuk kishin dalë kurrë hapur në vendin e punës u shprehën se ky kufizim u shkaktonte shpesh stres, izolim dhe i pengonte

në ndërtimin e rrjeteve profesionale apo përparimin në karrierë (p.sh., shmangia e pyetjeve personale ose e pjesëmarrjes në aktivitete shoqërore). Rreth 50% e atyre që nuk kishin dalë asnjëherë hapur si LGBTI+ në vendin e punës u shprehëhn se kishin frikë se mund të humbisnin punën, sidomos në kushtet ku janë të punësuar pa kontratë të rregullt dhe për pasojë pa mbrojtje të plotë ligjore.

Një gjetje shqetësuese e pyetësorit në seksionin e punësimit mbetet ajo mbi nivelet e larta të ngacmimeve seksuale në punë. Rreth 27% e të punësuarve LGBTI+ deklaruan se kishin përjetuar të paktën një herë gjatë vitit të fundit ngacmim seksual nga drejtues, kolegë apo klientë.

A jeni përballur me raste të ngacmimit seksual nga eprorët/kolegët/klientët në vendin e punës gjatë vitit të fundit?

186 responses




Kjo përqindje përfaqëson më shumë se 1 në 4 persona, çka tregon qartë mbi nevojën urgjente për zbatim më të mirë të politikave kundër ngacmimeve seksuale në vendin e punës për të gjithë.

## Strehimi

Strehimi i qëndrueshëm dhe i sigurt mbetet një nevojë themelore për personat LGBTI+ në Shqipëri. Një pjesë e konsiderueshme e të anketuarve raportuan se mbështeteshin ende te familja sa i përket strehimit, ku rreth 40% e tyre jetonin ende me prindërit, ndërsa 13% jetonin me të afërm të tjerë. Nga ana tjetër, 24% e të anketuarve jetonin vetëm dhe 14% e tyre me partnerin ose partneren dhe rreth 6% me miq, çka tregon se rreth 44% kanë forma më të pavarura jetese.

Me kë banoni aktualisht?

195 responses




Jetesa me familjen pavarësisht dimensionit mbështetës, shpesh për personat LGBTI+ përbën një eksperiencë të vështirë. Shumica e personave LGBTI+ që deklarojnë se jetojnë me prindërit apo të afërmit (59%), pohojnë se e kanë zgjedhur këtë alternativë vetëm për shkak të kushteve ekonomike, duke nënvizuar kompromisin që u duhet të bëjnë mes mbijetesës dhe mundësisë për të jetuar hapur si individ LGBTI+, si dhe mungesën e stabilitetit të kësaj forme strehimi nëse marrëdhëniet familjare përkeqësohen (p.sh., në rast se personi del hapur si LGBTI+ dhe nuk pranohet nga familjarët).

Sa i përket të drejtave të pronësisë, 42% e të anketuarve jetojnë në banesa me qira, 41% në banesa në pronësi të familjes dhe vetëm 11% janë pronarë të shtëpive të tyre.

Shtëpia ku banoj është:

195 responses




Një pjesë e vogël e të anketuarve (rreth 2%) ndodhen aktualisht në kushte të pasigurta strehimi dhe u duhet të banojnë në strehimore ose banesa me qira ditore. Dominimi i qiramarrjes dhe i banesave në pronësi të familjes si format kryesore të strehimit për personat LGBTI+, tregon se pronësia në favor të personave LGBTI+ mbetet tepër e rrallë.

Një e dhënë shqetësuese që rezulton nga përgjigjet e pyetësorit lidhet me ekzistencën e diskriminimit në strehim për personat LGBTI+. 17% e të anketuarve pohuan se gjatë vitit të fundit kishin hasur vështirësi për të gjetur ose mbajtur një banesë me qira për shkak të orientimit seksual apo identitetit gjinor.

A jeni përballur gjatë vitit të fundit me vështirësi gjatë marrjes apo mbajtjes me qira të një banese për shkak të orientimit seksual/identitetit gjinor?

195 responses




Kjo shifër nënkupton se afro 1 në 6 të anketuar është përballur me paragjykime

në tregun e qirasë për shkak të statusit LGBTI+. Duke marrë parasysh se jo të gjithë të anketuarit kanë qenë në proces kërkimi të një banese me qera gjatë vitit të fundit, kjo përqindje mbetet mjaft e lartë dhe tregon se një pjesë e konsiderueshme e qiramarrësve potencialë apo ekzistues LGBTI+ është përballur me diskriminim gjatë vitit të fundit. Një shqetësim specifik në këtë fushë përbën refuzimi i pronarëve qiradhënës t'u japin shtëpi çifteve të së njëjtës gjini apo që i perceptojnë si të tillë dhe personave transgjinerë. Disa të anketuar kanë raportuar raste përzëniesh nga banesa dhe ngacmimesh nga pronarët pasi ata ishin informuar për statusin LGBTI+ të qiramarrësve.

Ndër problematikat kryesore të raportuara janë përzënia nga banesa, e raportuar nga 32% e rasteve që patën një incident në fushën e strehimit gjatë vitit të fundit. Një pjesë e konsiderueshme e të anketuarve, rreth 44%, raportuan ngacmime nga pronarët dhe fqinjët si problemet kryesore me të cilat ishin ndeshur vitin e fundit në sferën e strehimit. Dhjetë të anketuar, rreth 19% e atyre që hasën vështirësi në strehim gjatë viti të fundit, u shprehën se pronari u bënte vizita të pa paralajmëruara si formë presioni ose kontrolli. 6 të anketuar u shprehën se gjatë viti të fundit përjetuan dhunë të drejtpërdrejtë nga fqinjët dhe 2 të anketuar raportuan dhunë të drejtëpërdrejtë nga pronari, që lidhej me orientimin seksual apo identitetin gjinor të tyre.

Nëse po, vështirësitë kryesore lidheshin me:

53 responses




Bazuar në këto të dhëna mund të konkludojmë, se personat LGBTI+ që identifikohen ose dyshohen nga pronarët si persona me orientim seksual apo

identitet gjinor jo hetero-cis-normativ shpesh përballen me incidente, konflikte dhe armiqësi që varion nga mikroagresionet deri te humbja e banesës.

Një sfidë tjetër për personat LGBTI+ në fushën e strehimit mbetet mungesa e aksesit në mbështetjen për strehim. Qeveria shqiptare ka disa programe për banesa sociale dhe subvencione qiraje për grupe të cënueshme, por vetëm 4% e të anketuarve pohuan se kanë përfituar nga ndonjë program apo politikë e tillë publike për strehim. Ndërkohë, mbi 90% e të anketuarve nuk kanë përfituar asnjëherë nga ndonjë program i ngjashëm. Në thelb, shumica dërrmuese mbështeten te zgjidhjet private për strehim ose te familja dhe asistenca shtetërore mbetet minimale në këtë drejtim.

A keni përfituar nga ndonjë program apo politikë publike strehimi?

195 responses




Vështirësitë e strehimit për personat LGBTI+ mbeten të lidhura ngushtë me kontekstin më të gjerë të pranimit familjar dhe shoqëror.

## Situata e Diskriminimit dhe Dhunës me Bazë Statusin LGBTI+

Përvojat me diskriminimin dhe dhunën e motivuar nga orientimi seksual jo heteroseksual dhe identiteti gjinor jo-cisgjnor mbeten fatkeqësisht të zakonshme në radhët e komunitetit LGBTI+ në Shqipëri gjatë vitit të fundit. Të pyetur nëse kishin përjetuar ndonjë incident dhune fizike apo diskriminimi për shkak të statusit të tyre LGBTI+ gjatë vitit të fundit, 38.5% e të anketuarve pohuan se kishin përjetuar personalisht dhunë dhe/ose diskriminim gjatë kësaj periudhe.

A jeni përballur me raste dhune dhe/ose diskriminimi gjatë vitit të fundit?

195 responses



22.6% e të anketuarve të tjerë kishin qenë dëshmitarë të një incidenti të tillë dhune dhe/ose diskriminimi që i kishte ndodhur një personi tjetër LGBTI+ që njihnin. Vetëm rreth 39% e të anketuarve deklaruan se nuk kishin përjetuar apo dëshmuar një incident të tillë gjatë vitit të fundit. Fakti se rreth 61% e të anketuarve kanë qenë në kontakt të drejtpërdrejtë ose kanë dëshmuar dhunë dhe/ose diskriminim për shkak të statusit LGBTI+ gjatë vitit të fundit, përbën një fakt tejet shqetësues.


Ku ndodhën këto incidente?

Të dhënat e mbledhura përmes pyetësorit tregojnë se hapësirat publike dhe rrjetet sociale janë vendet më të zakonshme ku personat LGBTI+ përjetojnë ose përballen me dhunë dhe/ose ngacmime serioze. Ndër ata që përshkruan vendndodhjen e incidentit, përgjigjet më të shpeshta ishin: “në një hapësirë

publike” (p.sh., rrugë, park)- 67 raste, dhe “në rrjetet sociale/online”- 65 raste. Kto shifra tregojnë se gjatë vitit të fundit incidentet dhe ngacmimet në rrugë dhe online ishin shumë të përhapura. Në hapësira publike, incidentet përfshinin sulme verbale apo fizike nga të panjohur në rrugë, ndërsa online, përfshinin bullizmin kibernetik, kërcënimet dhe ekspozimin e detyruar në rrjete sociale.

Nëse ju apo dikush që njihnit keni qenë viktima të dhunës/diskriminimit gjatë vitit të fundit, ku gjendeshit gjatë kohës që ndodhi incidenti (mund të përzgjidhni më tepër se një alternativë):

145 responses




Vendndodhjet më të shpeshta të këtyre incidenteve pas hapësirave publike dhe atyre online ishin shkolla ose universiteti (47 raste), çka tregon se institucionet arsimore janë shpesh vende ku ndodh abuzimi (siç është diskutuar edhe në seksionin mbi arsimin); lagjia (39 raste) dhe shtëpia (27 raste). 31 incidente ndodhën në bare ose restorante, çka tregon se edhe ambientet private mbeten në masë të madhe armiqësore ndaj personave LGBTI+. Vendet e punës përmenden në 28 raste, në përputhje me të dhënat për ngacmimin në punë. Janë përmendur gjithashtu 16 incidente të ndodhura në institucione shtetërore dhe 9 në ambientet e policies. Kategoria “Tjetër” mbi vendodhjen e incidentit është përzgjedhur në 22 raste dhe përfshin kryesisht udhëtime dhe evente kulturore.

Këto të dhëna tregojnë qartë se diskriminimi dhe dhuna e motivuar mbi baza të statusit LGBTI+ mund të ndodhin kudo: në rrugë, në shkollë, në shtëpi, online, në punë, madje edhe në institucione publike dhe nga autoritetet.

Shumë nga autorët mbeten të panjohur për të anketuarit. Në 84 raste ata raportuan se autori i diskriminimit/dhunës ishte i panjohur, në 36 raste autori ishte fqinj apo person pjesë e komunitetit të personave që përjetuan incidentin, në 19 raste autori ishte mik, në 17 raste ishte koleg, në po 17 raste autori ishte familjar, në 10 raste autori ishte punëdhënës dhe në 10 raste autori ishte punonjës i policisë apo i sistemit të drejtësisë.

Nëse keni informacione lidhur me autorin e incidentit, përzgjidhni 1 ose disa nga opsionet që lidhen me të (mund të përzgjidhni më tepër se një alternativë):


137 responses



Siç u përmend më herët, vetëm rreth 11.6% e viktimave pohuan se e raportuan zyrtarisht incidentin e fundit. Sipas anketës, 122 persona nuk e raportuan rastin e tyre institucionalisht, ndërsa 16 persona zgjodhën të raportonin.

A e raportuat incidentin tuaj?


138 responses



Nga ata që raportuan, shumica iu drejtuan policisë (12 raste), vetëm 2 raste iu drejtuan Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, 1 rast iu drejtua Avokatit të Popullit dhe 1 rast Prokurorisë.

Nëse po, në cilin/at nga organet/subjektet e mëposhtme e keni raportuar rastin (mund të përzgjidhni më tepër se një alternativë)?

42 responses




Rezultatet për ata që zgjedhën të raportojnë rastin e tyre ishin kryesisht zhgënjyese, pasi vetëm 2 raste morën një zgjidhje përfundimtare, 5 patën vetëm përparime të pjesshëm, ndërsa pjesa tjetër nuk mori asnjë përgjigje ose nuk ka asnjë informacion mbi ecurinë e çështjes.

Duke e lidhur këtë tablo me faktin se 88% e të anketuarve raportojnë se nuk i besojnë forcave të rendit, mbetemi brenda një cikli vicioz ku mungesa e besimit

çon në mosraportim, çka sjell mosndëshkueshmërinë e autorëve, fakt që si përfundim e përforcon edhe një herë mosbesimin e personave LGBTI+ në institucionet e rendit dhe drejtësisë.

A besoni në Institucionet e rendit në Shqipëri?

195 responses



Si përfundim, nga të dhënat e pyetësorit rezulton se diskriminimi dhe dhuna mbeten një realitet i shpeshtë për personat LGBTI+, që përfshin thuajse çdo fushë të jetës. Sistemet që duhet të mbrojnë viktimat e këtyre incidenteve (familja, komuniteti, policia, sistemi i drejtësisë) shpesh dështojnë në këtë mbrojtje, fakt ky që kontribuon në krijimin e një klime ku individët LGBTI+ duhet të jenë vazhdimisht vigjilentë dhe alertë. Siç tregojnë nevojat e raportuara për ndihmë psikologjike, kjo situatë urgjence rezulton në pasoja thelbësore për mirëqenien fizike, psikologjike dhe emocionale të personave LGBTI+.

## Nevojat Kryesore të Individëve LGBTI+ për Shërbime


Një nga objektivat kryesore të këtij pyetësori ishte të identifikonte se cilat shërbime mbështetëse të ofruara nga Aleanca LGBTI+ për individët LGBTI+ në Shqipëri mbeten më të nevojshme, për të ndihmuar në adresimin më të mirë të këtyre nevojave mes lobimit institucional dhe shpërndarjes së burimeve. Të anketuarit u ftuan të vlerësonin një listë shërbimesh në një shkallë nga 1 (“më pak e nevojshme”) deri në 3 (“shumë e nevojshme”). Këto shërbime përfshinin këshillimin psikologjik, ndihmën ligjore, asistencën për strehim, punësim, arsimim, kurset profesionale, rimbursimin e kostove mjekësore, rimbursimin e

qirasë, ndihmën ushqimore dhe rimbursimin e tarifave shkollore. Rezultatet e pyetësorit tregojnë një hierarki të qartë mes nevojave prioritare të të anketuarve, si vijon:

### Nevojat prioritare për shërbime (përqindja e atyre që i vlerësojnë si “shumë të nevojshme”):

- Këshillimi psikologjik dhe mbështetja për punësim ishin në krye të listës së nevojave, të dyja të vlerësuara si “shumë të nevojshme” nga rreth 70% e të anketuarve, pasuar nga nevoja për ndihmë dhe këshillim ligjor, që u vlerësua si “shumë e nevojshme” nga rreth 65% e të anketuarve;
- Më shumë se gjysma e të anketuarve, afro 51%, vlerësuan gjithashtu si shumë të nevojshme shërbimet që lidhen me strehimin dhe rimbursimin e vizitave mjekësore.
- Rreth 39% e të anketuarve vlerësuan si shumë të nevojshme kurset profesionale dhe ndihmën ushqimore.

Cilat prej shërbimeve të mëposhtme janë më të rëndësishme për ju? (1- më pak e nevojshme; 2- mesatarisht e nevojshme; 3- shumë e nevojshme)



### Këshillimi psikologjik

Shërbimi më i domosdoshëm sipas të anketuarve ishte këshillimi psikologjik, ku 70% e tyre e vlerësuan si shumë të nevojshëm. Duke marrë parasysh nivelet e larta të stresit, traumës dhe “stresit të pakicës” që përjeton komuniteti LGBTI+, kjo shifër nuk është befasuese. Qasja në këshillim psikologjik miqësor dhe të ndjeshëm ndaj çështjeve LGBTI+ mbetet vendimtare për përballimin e refuzimit nga familja, diskriminimit dhe luftës së brendshme me depresionin dhe ankthin. Kjo gjetje ravijëzon gjithashtu se shërbimet publike mbi shëndetin mendor në Shqipëri mbeten të kufizuara dhe shpesh nuk janë përfshirëse dhe të trajnuara ndaj çështjeve LGBTI+, ndërkohë që terapitë private janë të kushtueshme. Organizatat e shoqërisë civile, si Aleanca LGBTI dhe STREHA ofrojnë këshillim psikologjik, por me kapacitete të kufizuara, prandaj kjo gjetje shërben njëherazi

si thirrje për më shumë financim publik dhe mbështetje të dedikuar për shëndetin mendor të personave LGBTI+ nga sistemi publik.

### **Mbështetja për punësim**

Në vend të dytë, renditur si një shërbim shumë i nevojshëm, vjen mbështetja për punësim (68%), që përfshin orientim profesional, programe për përfshirje në vendin e punës, ndihmë për gjetjen e një pune dhe mbështetje për nismat e vetëpunësimit. Kijonevojë prioritare e identifikuar nga pyetësi përputhet me gjetjet e mëparshme mbi vështirësitë e shumta që komuniteti përjeton në tregun e punës. Për shumë persona LGBTI+, një mundësi për punësim të sigurt e të qëndrueshëm është e lidhur drejtpërdrejt me pavarësinë ekonomike dhe aftësinë për të ndërtuar një jetesë më të sigurt.

### **Këshillimi ligjor**

Këshillimi ligjor rezulton një ndër shërbimet më të kërkuara, ku 65% e të anketuarve e vlerësojnë si “shumë të nevojshëm”. Shumë persona LGBTI+ përballen me sfida ligjore si raste diskriminimi, ndryshim të dokumenteve, kallëzime për krime urrejtjeje, apo ndihmë në procedura emigrimi/kërkesa azili. Një shërbim i dedikuar për ndihmë ligjore mbetet kyç për fuqizimin e personave LGBTI+.

#### **Nevoja të tjera prioritare për shërbime**

- Strehimi i përkohshëm / ndihma për strehim u vlerësojnë si shumë të nevojshme nga 55% e të anketuarve, duke reflektuar sfidat e vazhdueshme të komunitetit në qasjen në strehim të sigurt.
- Rimbursimi i vizitave mjekësore (54%) dhe rimbursimi i barnave (48.5%) nënvizojnë sërish vështirësitë ekonomike por dhe vështirësitë e aksesit në kujdesin shëndetësor publik për personat LGBTI+, veçanërisht për personat transgjinerë.
- Rimbursimi i tarifave të shkollimit (44%) dhe rimbursimi i qirasë (43%) identifikohen gjithashtu si nevoja të rëndësishme të individëve LGBTI+, veçanërisht në radhët e atyre që janë larguar/dëbuar nga familja për shkak të statusit të tyre LGBTI+ duke humbur çdo mbështetje të jashtme ekonomike.

- Kurset profesionale dhe ndihma ushqimore u vlerësuan si shumë të nevojshme nga rreth 39% e të anketuarve. Megjithëse renditen si llojet e ndihmës më pak prioritare për nga përbindja e të anketuarve, këto shërbime mbeten thelbësore, veçanërisht për atë pjesë të personave LGBTI+ që janë në situatë papunësie dhe/ose në kushte ekonomike shumë të vështira.

## **Përfundim**

Pothuajse të gjithë të anketuarit vlerësuan të paktën një shërbim si “shumë të nevojshëm”, çka tregon rëndësinë që kanë këto forma mbështetjeje për personat LGBTI+ në Shqipëri.

Përmbledhtazi, shërbimet më prioritare të identifikuar sipas radhës janë:

- Këshillimi psikologjik
- Mbështetja për punësim
- Këshillimi ligjor
- Strehimi


Siç vihet re nga karakteri i tyre, këto shërbime nuk lidhen vetëm me ndihmën emergjente. Ato kanë të bëjnë me krijimin e stabilitetit emocional, ekonomik, sigurinë ligjore dhe mirëqenien e përgjithshme të individëve, duke shërbyer si forma të drejtpërdrejta suporti për fuqizimin e individëve LGBTI+. Këto gjetje nënvizojnë dhe hedhin dritë mbi nevojat prioritare të personave LGBTI+ për të ndërtuar jetë të qëndrueshme dhe të dinjitetshme mes dëshirës dhe nevojës për akses në arsimim, punë, shëndet të mirë, strehë të sigurt, drejtësi dhe njohje ligjore, prandaj këto prioritete duhet të vijojnë të udhëheqin punën advokuese të shoqërisë civile, politikave publike dhe programet e mbështetjes së komunitetit LGBTI+ në vijim.

## Largimi nga Vendi dhe Synimi për të Migruar

Një nga gjetjet më shqetësuese të këtij pyetësi është niveli i dëshirës së individëve LGBTI+ në Shqipëri për të lënë vendin, gjatë vitit të fundit. Kur u pyetën: “A e ke menduar ndonjëherë seriozisht largimin nga vendi gjatë vitit të fundit?”, 88.2% e të anketuarve u përgjigjën “Po”.

A keni menduar në ndonjë moment me seriozitet largimin nga vendi?

195 responses



Konkretisht, 172 nga 195 pjesëmarrës në pyetësor e kanë konsideruar emigrimin si një opsion real gjatë vitit të fundit. Kjo përqindje është shumë më e lartë se ajo në popullatën e përgjithshme shqiptare (e cila është gjithsesi e lartë, veçanërisht mes të rinjve) dhe përfaqëson përqindjen më të lartë të dëshirës për t`u larguar nga shqipëria mes personave LGBTI+ gjatë 5 viteve të fundit, çka dëshmon për një zhgënjim të thellë dhe mungesë shprese mes personave LGBTI+ lidhur me të ardhmen e tyre në Shqipëri.


Për të kuptuar më mirë këtë tendencë, është e rëndësishme të fokusohemi te shkaqet kryesore që i shtynë personat LGBTI+ drejt dëshirës dhe synimit për të lënë Shqipërinë. Në këtë linjë, të gjithë ata që u përgjigjën se e kishin konsideruar seriozisht largimin nga vendi gjatë vitit të fundit u pyetën mbi arsyet që i shtynë për të menduar largimin. Rezultatet tregojnë se motivet kryesore nuk janë thjesht ekonomike, por përfshijnë faktorë politikë dhe socialë të lidhur drejtpërdrejt me përvojën dhe statusin e tyre LGBTI+:

Ndër ata që kanë menduar seriozisht largimin (88% e të gjithë të anketuarve), arsyet më të përmendura ishin:

- Mungesa e lirisë dhe demokracia e dobësuar në Shqipëri (74%)
- Situata ekonomike (52%)
- Mungesa e njohjes ligjore të të drejtave LGBTI+ (47%)
- Mundësitë e pakta për punësim (43%)
- Arsye shkollimi (28%)
- Të tjera (21%) që përfshijnë arsye personale, bashkime familjare, nevoja mjekësore (sidomos për personat transgjinjorë), etj.

Nëse po, arsyet tuaja janë: (zgjidhni të gjitha opsionet e vërteta)

180 responses



Këto të dhëna në vetvete tregojnë për një krizë të thellë besimi të qytetarëve LGBTI+ ndaj institucioneve, politikave publike dhe shoqërisë në përgjithësi. Arsyeja më e përmendur si shkak kryesor që motivon synimin për t`u larguar nga vendi është mungesa e lirisë dhe përfshirjes demokratike (74%), çka tregon zhgënjimin e thellë ndaj sistemit politik dhe përjashtimin e vazhdueshëm të zërave të pakicave nga demokracia aktuale në Shqipëri. Për shumë persona LGBTI+, mungesa e sigurisë, mbrojtjes ligjore dhe përfaqësimit institucional e kthen Shqipërinë në një mjedis ku ndihen të huaj dhe ku jetesa me dinjitet bëhet pothuajse e pamundur. Kjo gjetje përforcohet nga fakti se vetëm 12% e të anketuarve shprehen se kanë besim tek institucionet ligjzbatuese në një realitet ku 85% e viktimave të diskriminimit nuk e kanë raportuar ngjarjen.

Përveç përjashtimit politik dhe shoqëror, situata ekonomike dhe mungesa e njohjes ligjore për komunitetin LGBTI+ janë shkaqe kryesore që i shtyjnë personat LGBTI+ drejt largimit nga vendi. Pamundësia për të krijuar një familje

të mbrojtur ligjërisht, për të përditësuar dokumentet personale të identifikimit për personat transgjnore si dhe mundësitë për të ndërtuar një jetë të barabartë me pjesën tjetër të shoqërisë, shtyn shumë individë LGBTI+ të shohin migrimin si e vetmja rrugë.

Në këto kushte, Shqipëria rrezikon të humbasë një pjesë thelbësore të qytetarëve LGBTI+, të cilët nëse do të ishin trajtuar në mënyrë të drejtë dhe të barabartë nga shteti shqiptar do të mund të ndërtonin jetët e tyre në Shqipëri dhe të kontribuonin në zhvillimin social dhe ekonomik të vendit.

Mesazhi është i qartë: “Shqipëria po i humbet të rinjtë LGBTI+ sepse nuk ndihen të mbrojtur, të sigurt, të barabartë dhe të përfaqësuar denjësisht.

Për ta kontrolluar e ndalur këtë prirje për largim mes qytetarëve LGBTI+, reformat e thella sistemike vijnë të mbeten nevojë imediate. Njohja ligjore e çifteve të të njëjtit seks, njohja ligjore e gjinisë për personat transgjnorë, forcimi i mbrojtjes kundër diskriminimit dhe krimeve të urrejtjes, mbështetja konkrete për punësim, arsim, strehim dhe shërbime psikologjike për personat LGBTI+, si dhe krijimi i një klime institucionale gjithëpërfshirëse mbeten thelbësore.

# Përmbledhje Krahasimore: Të Dhënat e Pyetësorit Vjetor 2024-2025 Përballë Gjetjeve të Periudhës 2020-2024

Gjatë pesë viteve të fundit, përparimi i Shqipërisë në drejtim të të drejtave të personave LGBTI+ ka qenë i kufizuar dhe jo i qëndrueshëm. Ky përfundim bazohet në të dhënat që do të pasqyrohen në vijim të këtij seksioni, i cili krahason të dhënat e pyetësorit të vitit 2024-2025 me prirjet e vërejtura përgjatë periudhës 2020-2024, për të evidentuar fushat ku ka pasur zhvillime pozitive, regres apo pandryshueshmëri në lidhje me situatën e komuniteteve LGBTI+.

## Njohja Ligjore e Personave LGBTI+

- 2020-2024: Pavarësisht advokimit të vazhdueshëm, nuk u miratua asnjë ligj për njohjen ligjore të çifteve të të njëjtit seks dhe as për njohjen ligjore të identitetit gjinor për personat transgjjinorë.
- 2024-2025: Nuk ka pasur asnjë reformë ligjore në drejtim të njohjes ligjore të çifteve të të njëjtit seks dhe personave transgjjinorë. Filluan dy procese litigimi strategjik në lidhje me këto çështje.
- Statusi: Situatë e pandryshueshme.
- Statistikë: 74% e të anketuarve përmendin mungesën e njohjes ligjore si arsye për të emigruar (nga 68% në 2020).

## Shëndetësia

- 2020-2024: Raportime të vazhdueshme për diskriminim; mungesë shërbimesh gjithëpërfshirëse; mungesë kujdesi specifik për personat transgjjinorë.
- 2024-2025: U punua mbi një protokoll për trajtimin hormonal të personave transgjjinorë, I cili vijon të mbetet i pamiruar; 25% e personave të anketuar LGBTI+ shmangën vizitat e nevojshme të shëndetit seksual dhe riprodhues nga frika e diskriminimit dhe 14% e atyre që aksesuan systemin shëndetësor u përballën me diskriminim.
- Statusi: Progres simbolik.
- Statistikë: 90% e personave transgjjinorë të anketuar nuk kanë mundur të kenë asnjë lloj konsulte mjekësore me një mjek vendas në lidhje me kujdesin afirmues gjinor.

## **Arsimi**

- 2020-2024: Raportime për bullizëm, mungesë informacioni nga mësuesit dhe stafi drejtues dhe përjashtim i çështjeve LGBTI+ nga kurrikulat edukese.
- 2024-2025: 73% e të anketuarve e konsiderojnë ambientin shkollor në shqipëri si të pasigurt për personat LGBTI+; 63% mendojnë se stafi edukues nuk është i informuar mbi çështjet LGBTI+, njësoj si në vitet e mëparshme.
- Statusi: Pandryshueshmëri.
- Statistikë: 25% e të anketuarve raportojnë vështirësi për të ndjekur shkollën për shkak të orientimit të tyre seksual dhe identitetit gjinor.

## **Punësimi**

- 2020-2024: Papunësi e lartë mes personave LGBTI+, raste të shpeshta punësimi informal dhe diskriminim në vendin e punës.
- 2024-2025: 47% janë të punësuar informalisht, 30% janë të papunë; 27% kanë përjetuar ngacmim në vendin e punës.
- Statusi: Asnjë përmirësim në përfshirjen në tregun e punës.
- Statistikë: 76% e të punësuarve formalë dhe informalë janë ndjerë të pasigurt në vendin e punës; 88% nuk kanë dalë asnjëherë hapur si LGBTI+ në vendin e punës nga frika e pasojave negative.

## **Strehimi**

- 2020-2024: Orientimi seksual dhe identiteti gjinor u njohën si kritere në ligjin për strehimin, por zbatimi i ligjit nuk ishte konsistent dhe i mjaftueshëm; probleme me konfidencialitetin të lidhura me sistemin e pikëzimit.
- 2024-2025: 17% raportuan diskriminim gjatë marrjes me qira të një banese; vetëm 4% përfituan nga programe publike strehimi. Rastet e ndjekjes nga banesa dhe përfundimit pa paralajmërim të marrëdhënieve të qirasë për shkak të statusit LGBTI+ janë në rritje.
- Statusi: Pandryshueshmëri.
- Statistikë: 50% e atyre që kërkuan një banesë me qira gjatë vitit të fundit u shprehën se u diskriminuan nga qiradhënësit.

## **Diskriminimi dhe Dhuna**

- 2020-2024: Nivele të larta dhune dhe ngacmimi; raportim i ulët për shkak të mosbesimit ndaj institucioneve.
- 2024-2025: Asnjë përmirësim. 42% përjetuan dhunë/diskriminim për shkak të statusit LGBTI+ dhe 88% u shrehën se nuk i besojnë policies dhe organeve të rendit. Rritje e gjuhës së urrejtjes si pasojë e forcimit të lëvizjeve anti-LGBTI+.
- Statusi: Përkeqësim i situatës së gjuhës së urrejtjes si pasojë e forcimit të lëvizjeve anti-LGBTI+.
- Statistikë: 85% e viktimave të dhunës/diskriminimit në lidhje me statusin LGBTI+ nuk e raportuan institucionalisht incidentin e tyre.

## **Emigrimi**

- 2020-2024: Rreth 65% kishin menduar seriozisht të largoheshin nga vendi.
- 2024-2025: Kjo shifër është rritur në 88%, duke reflektuar një zhgënjim të thelluar.
- Statusi: Regres i theksuar.
- Statistikë: Mungesa e njohjes ligjore, demokracia e dobësuar, diskriminimi dhe përjashtimi ekonomik janë shtytësit kryesorë për largimin e personave LGBTI+ nga vendi.

## **Nevojat për Shërbime**

- 2020-2024: Kërkesë e qëndrueshme për mbështetje psikologjike, ligjore dhe për strehim.
- 2024-2025: Nuk ka ndryshim në përparësi. Afro 70% kanë nevojë për këshillim psikologjik dhe strehim; 65% për ndihmë ligjore. Shërbimet publike mbeten të kufizuara; OJF-të mbulojnë shumicën e nevojave.
- Statusi: Nevoja të pazgjdhura dhe të qëndrueshme/Pandryshueshmëri.
- Statistikë: Më shumë se gjysma e të anketuarve kërkojnë gjithashtu ndihmë për arsim, strehim dhe rimbursim të shpenzimeve mjekësore.

**Tabela përmbledhëse e gjetjeve kryesore krahasimore mes vitit 2024-2025 dhe periudhës 2020-2024:**

Indikatori	2020-2024 (%)	2024-2025 (%)	Ndryshimi
Shqetësimi i personave LGBTI+ në lidhje me njohjen ligjore të bashkimeve të të njëjtit seks dhe identitetit gjinor	68	74	+6
Diskriminimi në Sistemin Shëndetësor	22	26.9	+4.9
Diskriminimi në Punësim	30	32	+2
Pasiguria në lidhje me strehimin	42	48.7	+6.7
Synimi për t`u larguar nga Shqipëria	65	82.2	+17.2
Bullizmi në shkollë	51	52.4	+1.4

## Përmbledhje:

Kjo analizë krahasuese konfirmon se në vend të progresit të synuar dhe shpresuar, shumë prej sfidave për komunitetin LGBTI+ mbeten prezente dhe janë thelluar. Në mungesë të mbrojtjes ligjore, ndryshimeve të synuara në politika dhe përgjigjes efektive nga institucionet ndaj rasteve të dhunës, diskriminimit dhe krimeve të urrejtjes, individët LGBTI+ në Shqipëri vazhdojnë të përballen me përjashtim, dhunë, vështirësi ekonomike dhe presion sistemik për t`u larguar nga vendi.

Në mënyrë të veçantë, mungesa e njohjes ligjore, diskriminimi i vazhdueshëm në shëndetësi, punësim dhe strehim, si dhe rritja e gjuhës së urrejtjes, vijnë të përbëjnë kërcënime të drejtpërdrejta për mirëqenien e personave LGBTI+ në vend.

## Përfundime dhe Rekomandime

Të dhënat e pyetësorit të vitit 2024 mbi situatatën e personave LGBTI+ në Shqipëri në fushat më thelbësore të jetës, ofrojnë një panoramë më të qartë të një komuniteti që vijon të përballlet me probleme të thella sistemike, si dhuna,

diskriminimi, mungesa e njohjes ligjore dhe mungesa e mbështetjes institucionale.

Në fusha si shëndetësia, arsimi, punësimi dhe strehimi, personat LGBTI+ vijojnë të raportojnë sfida të vazhdueshme që minojnë sigurinë dhe mirëqenien e tyre të përgjithshme. Siç reflektohet nga analiza e të dhënave pasqyruar në këtë raport përmbledhës, shumë individë LGBTI+ vijojnë të përballen me diskriminim nga profesionistë të shëndetit, të ndihen të pasigurt në shkolla dhe vende pune, dhe të hasin në paragjykime në sigurimin e strehimit. Sistemet aktuale të mbështetjes janë të pamjaftueshme, pasi besimi institucional mbetet tejet i ulët dhe vetëm një pakicë personash LGBTI+ përfiton nga programet publike të mbështetjes. Si pasojë, shumica dërrmuese e komunitetit LGBTI+ aktualisht po synon të ndërtojë një jetë me dinjitet jashtë vendit, jo vetëm për arsye ekonomike, por për të jetuar me dinjitet, në liri dhe baraza të plotë, në realitete ku njohja e të drejtave të tyre themelore si qenie njerëzore nuk është çështje për debat.

Nga ana tjetër, të dhënat e pyetësorit objekt i kësaj analize interpretuese identifikuan nevojat më urgjente dhe prioritare të personave LGBTI+ në kuadër të shërbimeve të ofruara. Ka një kërkesë të lartë të personave LGBTI+ për shërbime në sferën e mirëqenies psikologjike dhe emocionale, ndihmë ligjore, strehim të sigurt dhe më shumë mundësi për arsim dhe punësim. Këto nevoja përfshijnë fusha konkrete ku institucionet shtetërore, shoqëria civile dhe partnerët ndërkombëtarë duhet të kushtojnë më tepër vëmendje dhe burime.

Është e rëndësishme të theksohet se Shqipëria ka bërë disa përparime në kuadër të adresimit të çështjeve LGBTI, ndër të cilat përmendim kuadrin ligjor për mbrojtjen nga diskriminimi dhe Planin Kombëtar të Veprimit për personat LGBTI+, megjithatë zbatimi i këtyre instrumenteve lë shumë për të dëshiruar.

Nga perspektiva e advokimit, gjetjet e këtij raporti janë thelbësore. Ato ofrojnë një bazë të dhënash sasiore dhe statistikash për kërkesat që prej kohësh janë ngritur nga organizatat LGBTI+ në mënyrë cilësore, shifra që i japin peshë konkrete kërkesave për ndryshime politike, ligjore dhe shpërndarje efektive të burimeve. Gjithashtu, këto të dhëna mund të përdoren për të matur përparimin në vitet që vijnë (nëse pyetësi përsëritet, mund të vlerësojmë nëse përqindjet janë përmirësuar, përkeqësuar apo kanë mbetur të pandryshuara pas ndërhyrjeve specifike).

Në përmbyllje, ky raport shërben si një dëshmi se edhe pse personat LGBTI+ në Shqipëri vijojnë të jenë të marginalizuar, ata nuk janë të padukshëm.

Të dhënat e përmbledhura në këtë raport dëshmojnë sfidat, nevojat dhe shpresat e komuniteteve LGBTI+, të cilat përmbledhen në një listë të detajuar rekomandimesh, si vijon:

## **REKOMANDIME PËR PËRMIRËSIMIN E SITUATËS SË PERSONAVE LGBTI+ NË SHQIPËRI (2024-2025)**

### **Korniza Ligjore, Diskriminimi dhe Krimet e Urrejtjes**

Të konsiderohet amendimi i Kushtetutës Shqiptare për të përfshirë mbrojtje më të qarta për orientimin seksual, identitetin gjinor dhe karakteristikat gjinore.

Të miratohet korniza ligjore për njohjen ligjore të identitetit gjinor mbi bazën e vetëidentifikimit, pa kërkesa të shtuara mjekësore dhe administrative për personat transgjjinorë.

Të miratohet korniza ligjore për njohjen e bashkëjetesës ligjore dhe martesës për çiftet e së njëjtës gjini.

Të garantohen të drejta të barabarta prindërimi për çiftet e të njëjtit seks, përfshirë aksesin në adoptim dhe riprodhim të asistuar.

Të përmirësohet parashikimi aktual mbi nxitjen e urrejtjes, sipas nenit 265 të Kodit Penal dhe të miratohet legjislacion specifik për krimet dhe gjuhën e urrejtjes me bazë orientimin seksual dhe identitetin gjinor, dhe të garantohet ndjekje penale efektive.

### **Zbatimi i Planit Kombëtar të Veprimit për Personat LGBTI+ 2021-2027**

Të sigurohet zbatim rigoroz i Planit Kombëtar të Veprimit për Personat LGBTI+ përmes alokimit të burimeve të posaçme financiare dhe njerëzore.

Të krijohen mekanizma të qartë monitorimi dhe llogaridhënieje që përfshijnë shoqërinë civile dhe përfaqësues të komunitetit LGBTI+.

Të rishikohet dhe përditësohet periodikisht Plani në bazë të evidencave të reja, monitorimeve dhe rekomandimeve nga aktorët relevantë.

Të promovohet transparenca dhe përfshirja publike në zbatimin e Planit, përmes fushatave informuese dhe takimeve të hapura.

## **Arsimi**

Të përfshihet edukimi seksual gjithëpërfshirës dhe çështjet e ndryshme që lidhen me orientimin seksual dhe identitetin gjinor në kurrikulën kombëtare.

Të implementohen trajnime të detyrueshme për mësuesit dhe stafin shkollor mbi çështjet LGBTI+.

Të zbatohen politika të rrepta kundër bullizmit në çdo institucion arsimor me komponentë të qartë për mbrojtjen e nxënësve LGBTI+.

## **Shëndetësia**

Të miratohet protokoll kombëtar për trajtimin hormonal të personave transgjinorë.

Të ndalohen me ligj (protokoll nuk është i mjaftueshëm) ndërhyrjet jo të domosdoshme dhe jo-konsensuale mbi fëmijët interseks dhe të garantohet autonomia e tyre trupore.

Të trajnohen vazhdimisht dhe në mënyrë detyruese profesionistët e shëndetësisë për të ofruar kujdes gjithëpërfshirës dhe pa paragjykim për personat LGBTI+.

## **Strehimi**

Të zbatohet në praktikë ligji për strehimin social që përfshin si kritere orientimin seksual dhe identitetin gjinor.

Të garantohen masa konfidencialiteti gjatë aplikimit për strehim dhe të adresohet diskriminimi gjatë procesit të aplikimit nga autoritetet vendore.

Të mbështetet zgjerimi i qendrave të strehimit emergjent dhe të ndërtohet një sistem strehimi afatgjatë për të rinjtë LGBTI+ në rrezik.

## **Punësimi**

Të forcohen mekanizmat e inspektimit dhe ndëshkimit të diskriminimit në vendin e punës mbi bazat e orientimit seksual dhe identitetit gjinor.

Të promovohen politika të punësimit që garantojnë diversitet, gjithëpërfshirje dhe barazi.

Të mbështeten programet e praktikave profesionale dhe zhvillimit të sipërmarrjeve queer për të rinjtë LGBTI+.





Alliance Against Discrimination of LGBTI

May 2025

# **Albania's LGBTI+ Communities in Focus**

Insights from the 2024 Survey and Trends Since 2020

Author: LL.M Dea Nini



**erim**  
Equal Rights  
Independent  
Media



**GLOBAL FUND FOR  
WOMEN**

**EQUALITY  
FUND**

This report is prepared independently by the authors.  
The content and opinions do not necessarily represent the official viewpoints  
of the donors or other mentioned institutions.

## **Table of Contents**

- 1 Introduction
- 2 Access to Healthcare for LGBTI+ Individuals
- 3 Legal Recognition of LGBTI+ Persons and Institutional Access
- 4 Education and Access to the School System
- 5 Employment
- 6 Housing
- 7 Discrimination and Violence Based on LGBTI+ Status
- 8 Key Service Needs Among LGBTI+ Individuals
- 9 Leaving the Country and Migration Intentions
- 10 Comparative Overview: 2024-2025 Annual Survey vs. 2020-2024 Trends
- 11 Conclusions and Recommendations

## Introduction

In 2024, Aleanca LGBTI conducted a nationwide questionnaire involving 195 self-identified LGBTI+ individuals across 12 cities in Albania. The aim was to assess their overall situation, most pressing needs, and access to guaranteed rights and services. Respondents ranged in age from 14 to over 50 years, with an average age of around 29, and the majority under 30. The survey included a broad diversity of sexual orientations, gender identities, and sex characteristics: 37.5% identified as gay men, 19% as lesbian women, 26.5% as bisexual individuals, 8% as transgender, and 4% as non-binary. A small percentage, 0.5% identified as intersex, while another 4.5% chose other diverse identities not specifically listed in the questionnaire.

While the sample was geographically inclusive, a considerable portion (60%) of respondents resided in the Tirana region, reflecting the urban concentration of Albania's LGBTI+ population. Notably, only 25% of respondents reported having accessed services or visited the Aleanca LGBTI community center or other organizations working with LGBTI+ communities, suggesting that a significant share of the community remains disconnected from formal support networks and structured advocacy spaces.

## Objectives and Methodology

This report aims to:

- Document the current realities and challenges faced by LGBTI+ people in Albania, based on first-hand data collected for the 2024-2025 period;

- Analyze the structural and social inequalities faced by LGBTI+ individuals in key aspects of daily life such as healthcare, legal recognition, education, employment, housing, safety, and access to services;

- Compare the 2024-2025 data with findings from the previous four-year period (2020-2024), to identify trends of progress, stagnation, or regression in access to rights, legal recognition, and inclusive services for LGBTI+ persons.

The questionnaire included both closed- and open-ended questions, enabling a combination of quantitative data collection and qualitative interpretation. Data was gathered through an online survey as well as through direct outreach in community spaces, ensuring the inclusion of voices often excluded from formal consultation processes.

## **Structure and Analytical Approach**

The report presents a thematic breakdown of findings across eight key areas: healthcare, legal recognition, education, employment, housing, discrimination and violence, service needs, and migration intentions. Each section provides a statistical overview supported by narrative interpretation, referencing both national legal frameworks and Albania's international human rights obligations on LGBTI+ issues. Furthermore, each section includes a comparative analysis between the 2024-2025 data and the 2020-2024 period to evaluate whether the situation for LGBTI+ individuals has improved, worsened, or remained unchanged over the last year in relation to the previous four years.

## **Access to Healthcare for LGBTI+ Individuals**

LGBTI+ respondents in the 2024-2025 survey reported significant challenges in accessing inclusive healthcare. Nearly two-thirds (68%) had sought medical services at least once in the past year. Among them, around 14% experienced discrimination by healthcare personnel due to their LGBTI+ status, a concerning figure given that healthcare environments should be safe for all. This result underscores the limited access that LGBTI+ individuals have to primary and sexual healthcare in Albania, an issue also highlighted in numerous advocacy reports during the 2020-2024 period. Of those who faced discrimination, 59% reported that it came from family doctors or hospital staff, while 41% said the mistreatment came from nurses or even other patients. These figures reveal that prejudice and discriminatory behavior against LGBTI+ people persist at multiple levels within the healthcare system.

A particularly alarming finding is the avoidance of needed medical care due to fear of stigma and discrimination. While 29% reported having attended sexual or reproductive health check-ups in the past year, nearly one-quarter (25%) said

they had avoided such care even though they felt it was necessary. This option, “I avoided sexual and reproductive health services even though I felt I needed them”, was selected by 1 in 4 respondents. This highlights a group of LGBTI+ individuals potentially at risk of untreated health conditions because they do not feel safe accessing gynecological, urological, or sexual health services. The avoidance of essential check-ups due to fear of judgment or mistreatment is a clear indicator of how stigma creates real barriers to care.

Access to specialized healthcare for transgender and non-binary individuals remains extremely limited. Of the 24 respondents who identified as transgender or non-binary, only 2 were able to consult a local doctor about hormone therapy or other gender-affirming medical interventions in the past year. The remaining 90%+ reported no such access, reflecting the continued failure of Albania’s healthcare system to address the specific health needs of transgender people. Although Albania has recently drafted a medical protocol for hormonal treatment of transgender individuals, it has not yet been formally approved, and therefore remains unimplemented. The sole intersex respondent reported having undergone unnecessary and non-consensual medical interventions during childhood, once again raising concern about harmful medical practices on intersex children in the absence of regulation and informed consent standards.

Access to healthcare for lesbian and bisexual women is also marked by exclusion and avoidance. Among those who identified as lesbian or bisexual women, only 19% reported having visited a gynecologist or reproductive health specialist in the past year, while over 28% intentionally avoided such visits despite feeling they needed them. These figures suggest that persistent stigma and lack of trust in doctors continue to drive many women in the LGBTI+ community away from essential care. Notably, only one in four lesbian/bisexual women who wished to become parents said they would consider using fertility services (such as IVF) within Albania. When asked about their family planning intentions, 27% said they would undergo in-vitro fertilization domestically, but the majority (55%) said no, and 17% said they would prefer adoption. This reluctance to use IVF services in Albania likely reflects a lack of confidence in the system’s ability to treat lesbian couples (or single women) with dignity, as well as the absence of legal provisions recognizing same-sex couples’ right to family formation.

Gay and bisexual men expressed strong interest in modern HIV prevention methods but revealed information gaps. Among male respondents identifying as gay or bisexual, 66% said they would be interested in using PrEP or PEP (pre- and post-exposure prophylaxis for HIV) if it were available in the country. However, 18% said they had no knowledge of these methods, and another 16% were not interested. The high level of interest suggests substantial demand for PrEP and PEP programs in Albania, while the information gaps indicate a need for expanded education and outreach. Awareness-raising efforts could help ensure that these preventive tools are accessible and widely understood.

## **Legal Recognition of LGBTI+ Persons and Institutional Access**

Legal recognition of LGBTI+ rights in Albania remains extremely limited, as reflected in the 2024-2025 survey findings. The country still does not legally recognize same-sex unions, either civil partnerships or marriages, nor does it provide a procedure for legal gender recognition for transgender individuals. This absence of legal acknowledgement translates into a pervasive sense of exclusion and legal insecurity for LGBTI+ citizens. “Lack of legal recognition” was cited by nearly half (48%) of respondents as a primary reason for considering emigration (as further discussed in the Migration section). A significant majority of LGBTI+ respondents expressed that, without legal recognition of their relationships and identities, they feel like second-class citizens with denied rights that others enjoy, such as marriage, civil union, inheritance, adoption, parental rights, or even the basic right to have identity documents that reflect their gender identity.

Regarding awareness of legal guarantees, the survey data show that only 22% of respondents were aware that Albania has a National Action Plan for LGBTI+ persons. This suggests that the vast majority of LGBTI+ individuals are unaware of the state’s obligations and commitments under this framework. This alone highlights that both the 2016-2020 and 2021-2027 National Action Plans have not been sufficiently promoted or implemented. In fact, most of the plan’s measures remain unexecuted.

When it comes to the key state institutions tasked with protecting the human rights of LGBTI+ people, respondents expressed low levels of awareness and

trust. Only 36% said they were aware of the work or role of the Commissioner for Protection from Discrimination, while the rest did not know about this equality body. Meanwhile, 90% of all respondents stated that they had never reported an incident of discrimination or violence to the Commissioner, the Police, or the Ombudsman. The survey findings reveal deep distrust in Albania's law enforcement system: 88% of respondents reported that they do not trust law enforcement institutions. This high level of mistrust goes hand in hand with the low institutional reporting of violence and discrimination experienced by LGBTI+ individuals.

The European Commission's Progress Report on Albania emphasized that discrimination remains "widespread, particularly in access to healthcare, education, justice, employment, and housing," and noted that by 2023, 51% of LGBTI+ individuals in Albania felt discriminated against in at least one area of life<sup>3</sup>. This context reinforces that although legal guarantees do exist on paper to protect LGBTI+ individuals, their enforcement in practice remains weak.

The low number of reports made by victims in our survey mirrors official data showing that very few cases of hate crimes or discrimination involving LGBTI+ persons are addressed by law enforcement, independent institutions, or the justice system. According to our findings, only 16 individuals, just 11.6% of those who had experienced serious incidents in the past year, reported their case to a public authority. This means that only 1 in 11 serious incidents of violence or discrimination is formally reported. Of those who did report their case to the police or another institution, only 2 people (12.5%) received a final resolution. The majority received no follow-up, and many remain unaware of any developments regarding their case. This illustrates a cycle of impunity and disengagement that contributes to the community's broader sense of abandonment by institutions.

---

<sup>3</sup> Link:

[https://enlargement.ec.europa.eu/document/download/a8eec3f9-b2ec-4cb1-8748-9058854dbc68\\_en?filename=Albania%20Report%202024.pdf](https://enlargement.ec.europa.eu/document/download/a8eec3f9-b2ec-4cb1-8748-9058854dbc68_en?filename=Albania%20Report%202024.pdf)

## Education and Access to the School System

